

PROGRAMI I CIKLIT TË DYTË TË STUDIMIT

MASTER SHKENCOR NË “SHKENCA REHABILITUESE TË PROFESIONEVE TË SHËNDETIT” JOINT DEGREE

Programi i studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në “**Shkenca Rehabilituese të Profesioneve të Shëndetit**”, i organizuar dhe ofruar në kuadër të një programi të përbashkët ndëruniversitar (Joint Degree) nga Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit të Universitetit të Sporteve të Tiranës, në bashkëpunim me Universitetin “Magna Graecia” të Katanzaros, Itali, synon formimin e specialistëve të avancuar në fushën e rehabilitimit dhe të profesioneve të shëndetit.

Ky program ofrohet për herë të parë në vitin akademik 2026–2027, mbështetur në Urdhrin nr. 452 , datë 04.09.2026, të Ministrit të Arsimit.

Programi është hartuar për t’ju përgjigjur kërkesave bashkëkohore të sistemit shëndetësor, spitaleve, qendrave të rehabilitimit dhe klinikave të specializuara për profesionistë të aftë në vlerësimin, diagnostikimin funksional dhe trajtimin e rasteve komplekse klinike mbështetur në praktikat e bazuara në evidencë shkencore.

Karakterit **Joint Degree** i programit krijon një kuadër të integruar akademik dhe ndërkombëtar, duke mundësuar shkëmbimin e njohurive, metodologjive dhe praktikave më të mira ndërmjet dy institucioneve të arsimit të lartë. Programi synon të pajisë studentët me kompetenca të avancuara profesionale, klinike dhe kërkimore, duke i përgatitur ata për të përballuar në mënyrë efektive nevojat bashkëkohore të rehabilitimit dhe për të kontribuar në zhvillimin e shërbimeve shëndetësore dhe rehabilituese në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME MBI PROGRAMIN

- **Programi i studimit:** Master Shkencor në “Shkenca Rehabilituese të Profesioneve të Shëndetit”
- **Cikli i studimit:** Cikli i dytë i Studimeve të Larta
- **Kohëzgjatja:** 2 vite akademike / 4 semestra
- **Gjuha e Mësimdhënies:** Italisht/Anglisht
- **Kredite:** 120 ECTS
- **Forma e studimit:** Me kohë të plotë
- **Emërtimi i diplomës:** “Shkenca Rehabilituese të Profesioneve të Shëndetit ”
- **Departamenti përgjegjës:** Departamenti i Kineziologjisë

OBJEKTIVAT E PROGRAMIT DHE FORMIMI PROFESIONAL

Masteri Shkencor në “Shkenca Rehabilituese të Profesioneve të Shëndetit” ka si objektiva kryesore:

1. Të ofrojë njohuri të thelluara dhe bashkëkohore shkencore në fushën e rehabilitimit dhe të profesioneve të shëndetit.
2. Të zhvillojë kompetenca të avancuara profesionale dhe klinike për vlerësimin, planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e ndërhyrjeve rehabilituese.
3. Të aftësojë studentët për të kryer vlerësime të gjithanshme funksionale, duke identifikuar nevojat individuale të personave me dëmtime, kufizime funksionale ose probleme të ndryshme shëndetësore.
4. Të përgatisë profesionistë të aftë për të hartuar dhe zbatuar programe rehabilitimi të personalizuar, të bazuara në nevojat dhe objektivat e individit.
5. Të promovojë përdorimin e praktikave të bazuara në evidencë shkencore (evidence-based practice) dhe aplikimin e metodave bashkëkohore në rehabilitim.
6. Të zhvillojë aftësitë për punë multidisciplinare dhe bashkëpunim ndërprofesional me profesionistë të ndryshëm të sistemit shëndetësor.
7. Të forcojë aftësitë e studentëve në kërkimin shkencor, analizën kritike dhe interpretimin e literaturës shkencore, duke i përgatitur për realizimin e studimeve dhe projekteve kërkimore.
8. Të zhvillojë aftësinë për të vlerësuar rezultatet e ndërhyrjeve rehabilituese dhe për të përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme cilësinë e shërbimeve të ofruara.
9. Të promovojë një qasje holistike dhe të orientuar drejt individit, duke marrë në konsideratë aspektet fizike, funksionale, psikologjike dhe sociale të rehabilitimit.
10. Të përgatisë specialistë të aftë për të kontribuar në zhvillimin dhe përmirësimin e shërbimeve rehabilituese në institucione shëndetësore, rehabilituese, sociale dhe komunitare.
11. Të krijojë bazën e nevojshme akademike dhe profesionale për vazhdimin e studimeve të mëtejshme universitare dhe kërkimore, përfshirë studimet e ciklit të tretë.

STRUKTURA E PLANIT MËSIMOR

Plani mësimor organizohet me një shpërndarje graduale modularesh teorike, klinike dhe kërkimore:

Viti I

Lënda	Kredite	Vlerësimi
Edukim Profesional Shëndetsor <i>Moduli A: Pedagogji e Përgjithshme dhe Sociale</i> <i>Moduli B: Mësimdhënie dhe Pedagogji Speciale</i>	4 2 2	Provim
Statistikë dhe Menaxhim <i>Moduli A: Higjenë e Përgjithshme dhe e zbatuar</i> <i>Moduli B: Organizimi i Kompanisë</i>	6 3 3	Provim
Mjekësi e Brendshme Fizike dhe Rehabilitimi <i>Moduli A: Mjekësi Interne</i> <i>Moduli B: Nefrologji</i> <i>Moduli C: Mjekësi Fizike dhe Rehabilituese</i> <i>Moduli D: Farmakologji</i>	8 2 2 3 1	Provim
Psikiatri dhe Neurologji <i>Moduli A: Psikiatri</i> <i>Moduli B: Neuropsikiatri Infantile</i> <i>Moduli C: Neurologjia</i> <i>Moduli D: Farmakologjia</i>	8 3 2 2 1	Provim
Mjekësi Ligjore e Profesionit dhe Parandalimet <i>Moduli A: Higjenë e Përgjithshme e Zbatuar</i> <i>Moduli B: Mjekësi Ligjore</i> <i>Moduli C: Sëmundjet Infektive</i> <i>Moduli D: Mikrobiologji dhe Mikrobiologji Klinike</i> <i>Moduli E: Institucionet e së Drejtës Publike</i> <i>Moduli F: Gjuhë Angleze</i> <i>Moduli G: Lëndë me zgjedhje</i> <i>Moduli H: Praktike- Viti I 1-rë</i> <i>(Aktivitete të Tjera Informatikë, Laboratorë ETJ.)</i>	35 2 2 1 1 2 4 3 15 5	Provim
Totali i krediteve	61	

Viti II

Lënda	Kredite	Vlerësimi
Shkencat dhe Teknikat e Aplikuara në Rehabilitim <i>Moduli A: Shkencat e Infermierisë dhe Teknikat Neuropsikiatrike dhe të Rehabilitimit</i> <i>Moduli B: Sisteme të Perpunimit të Informacionit</i> <i>Moduli C: Bioinxhinieria Elektronike dhe Kompjuterike</i> <i>Moduli D: Fizikë e Aplikuar</i>	7 3 1 2 1	Provim

Rehabilitim Motorik	8	Provim
<i>Moduli A: Shkencat e Infermierisë dhe Teknikat Neuropsikiatrike dhe të Rehabilitimit</i>	3	
<i>Moduli B: Mjekësi Fizike dhe Rehabilituese</i>	2	
<i>Moduli C: Sëmundjet e Sistemit Lokomotor</i>	2	
<i>Moduli D: Shkencat Mjekësore Teknike të Zbatuara</i>	1	
Psikologji Klinike dhe Sociologji	9	Provim
<i>Moduli A: Psikologji Zhvillimore dhe Psikologji Edukimi</i>	4	
<i>Moduli B: Psikologji e Përgjithshme</i>	3	
<i>Moduli C: Sociologji e Përgjithshme</i>	2	
Rehabilitim i Specializuar	5	Provim
<i>Moduli A: Otorinolaringologjia</i>	1	
<i>Moduli B: Audiologjia</i>	1	
<i>Moduli C: Glotologji dhe Linguistikë</i>	1	
<i>Sëmundjet e aparatit të shikimit</i>	2	
Ekonomi dhe e Drejta	30	Provim
<i>Moduli A: E drejta Administrative</i>	2	
<i>Moduli B: E drejta e Punës</i>	2	
<i>Moduli C: Ekonomia e Biznesit</i>	1	
<i>Moduli D: E Drejta Ndërkombëtare</i>	2	
<i>Moduli E: Mësimdhënie me Zgjedhje</i>	3	
<i>Moduli G: Praktikë-Viti 2- Të</i>	15	
<i>Moduli F: Test Përfundimtar</i>	5	
Totali i krediteve	59	

STAFI AKADEMIK

Programi i studimit të ciklit të dytë **Master i Shkencave në “Shkenca Rehabilituese të Profesioneve të Shëndetit”**, i organizuar në kuadër të një **programi të përbashkët ndëruniversitar (Joint Degree)** ndërmjet Universitetit të Sporteve të Tiranës dhe Universitetit **“Magna Graecia” të Katanzaros, Itali**, do të mbështetet në një staf akademik të specializuar dhe me eksperiencë të konsoliduar në fushat e rehabilitimit dhe të profesioneve të shëndetit.

Në përputhje me marrëveshjen dhe strukturën e programit të përbashkët, **stafi akademik dhe pedagogjik i programit do të mbulohet tërësisht nga Universiteti “Magna Graecia” i Katanzaros, Itali**. Angazhimi i stafit akademik të këtij universiteti garanton përfshirjen e pedagogëve dhe ekspertëve me formim të avancuar akademik, përvojë në mësimdhënie universitare, kërkim shkencor dhe praktikë profesionale në fushën e shkencave rehabilituese dhe të shëndetit.

Përfshirja e stafit akademik të Universitetit “Magna Graecia” synon të sigurojë **standardizimin dhe cilësinë akademike të programit**, si dhe përafrimin e përmbajtjes së tij me zhvillimet

bashkëkohore evropiane dhe ndërkombëtare në fushën e rehabilitimit. Ekspertiza e pedagogëve do të kontribuojë në zhvillimin e njohurive teorike dhe praktike të studentëve, në përdorimin e metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies dhe në integrimin e kërkimit shkencor me praktikën profesionale.

Struktura e stafit akademik do të mundësojë gjithashtu një **qasje multidisiplinare**, duke përfshirë ekspertizë nga fusha të ndryshme të shkencave të rehabilitimit dhe profesioneve të shëndetit. Kjo qasje është në përputhje me karakterin e programit Joint Degree dhe synon t'u ofrojë studentëve një formim të integruar, ndërdisiplinor dhe me dimension të fortë ndërkombëtar.

Përfshirja e Universitetit “Magna Graecia” të Katanzaros në mbulimin e plotë të stafit akademik përbën një element të rëndësishëm të vlerës së shtuar të programit, duke krijuar mundësi për **transferimin e njohurive dhe eksperiencës ndërkombëtare, zhvillimin e bashkëpunimit akademik dhe kërkimor, si dhe rritjen e konkurrueshmërisë së të diplomuarve në tregun kombëtar dhe evropian të punës.**

PERSPEKTIVA E KARRIERËS DHE STUDIMET E MËTEJSHME

Përfundimi i programit të **Masterit Shkencor në “Shkenca Rehabilituese të Profesioneve të Shëndetit”** krijon mundësi të gjera për zhvillimin e mëtejshëm profesional dhe akademik të të diplomuarve. Formimi i avancuar teorik, praktik dhe kërkimor i fituar gjatë programit i përgatit studentët për të ushtruar veprimtarinë e tyre në fusha të ndryshme të shërbimeve shëndetësore dhe rehabilituese.

Të diplomuarit mund të zhvillojnë karrierën në **institucione shëndetësore publike dhe private, qendra rehabilitimi, struktura komunitare, institucione sociale, qendra të kujdesit për personat me aftësi të kufizuara**, si dhe në organizata dhe projekte që lidhen me shëndetin, rehabilitimin dhe mirëqenien e individit. Njohuritë e avancuara mund t'u mundësojnë gjithashtu marrjen e roleve më të specializuara në vlerësimin funksional, planifikimin dhe menaxhimin e programeve rehabilituese, edukimin shëndetësor dhe koordinimin e shërbimeve rehabilituese.

Një tjetër perspektivë e rëndësishme është përfshirja në **kërkimin shkencor dhe zhvillimin akademik**. Programi u ofron studentëve bazën e nevojshme për të analizuar literaturën shkencore, për të zhvilluar projekte kërkimore dhe për të kontribuar në përmirësimin e praktikave profesionale nëpërmjet përdorimit të evidencës shkencore.

PROCEDURA E APLIKIMIT DHE REGJISTRIMIT

Pranimet në programin **Master Shkencor në “Rehabilitim të Profesioneve të Shëndetit”** kryhen sipas kriterëve, procedurave dhe afateve të përcaktuara nga Universiteti i Sporteve të Tiranës, në përputhje me udhëzimet e Ministrisë përgjegjëse për Arsimin e Lartë.

Kandidatët e interesuar ftohen të ndjekin njoftimet zyrtare në uebsajtin e Universitetit për kriteret e pranimit, dokumentacionin e kërkuar dhe kalendarin e aplikimeve.

KRITERET E PRANIMIT NË PROGRAMIN E STUDIMIT

Pranimi në programin e studimit Master Shkencor në “Rehabilitim të Profesioneve të Shëndetit” realizohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për arsimin e lartë dhe rregulloret e institucionit, duke garantuar një proces përzgjedhjeje transparent dhe të bazuar në meritë.

Ky program është i hapur për kandidatët që kanë përfunduar studimet e ciklit të parë (Bachelor) në fusha të lidhura me kujdesin shëndetësor, si fizioterapia, infermiera, mjekësia e përgjithshme, si dhe disiplina të tjera të afërta me rehabilitimin. Qëllimi është të sigurohet që studentët e pranuar të kenë një bazë të qëndrueshme njohurish mbi të cilën mund të ndërtojnë kompetencat e avancuara që ofron programi.

Një element i rëndësishëm në procesin e pranimit është performanca akademike e kandidatëve, e reflektuar në mesataren e studimeve të mëparshme, e cila duhet të përmbushë pragun minimal të përcaktuar nga institucioni. Përveç kësaj, duke qenë se programi zhvillohet në një kontekst të ndërkombëtarizuar dhe në bashkëpunim me një universitet evropian, kandidatët pritet të kenë njohuri të një gjuhe të huaj, kryesisht anglisht ose italisht, në mënyrë që të përfitojnë plotësisht nga literatura, komunikimi akademik dhe komponentët ndërkombëtarë të programit.

Procesi i përzgjedhjes mund të përfshijë gjithashtu një intervistë ose një formë tjetër vlerësimi, përmes së cilës synohet të evidentohen motivimi i kandidatëve, interesi për fushën e rehabilitimit, si dhe aftësitë e tyre profesionale dhe komunikuese. Kjo fazë ndihmon në përzgjedhjen e studentëve që jo vetëm plotësojnë kriteret akademike, por gjithashtu kanë potencial për t'u zhvilluar si profesionistë të suksesshëm në këtë fushë.

KRITERET E PRANIMIT			
Numri minimal i studentëve	10	Numri maksimal i studentëve	10
Titujt e studimit që duhen patur për pranim		▪ Diplomë Bachelor në Shkenca Rehabilitimi, Fizioterapi, Fusha e veprimtarisë fizike, shëndetit dhe rekreacionit apo diploma të ngjashme me to. ▪ Diplomë në mjekësi të përgjithshme ▪ Diplomë të universiteteve të tjera brenda ose jashtë vendit të njëvlefshme me diplomat e sipërpërmëndura	
Kriter tjetër		• Kriteret e çdo viti të përcaktuara gjatë planifikimit të kuotave të vitit pasardhës	